


**JURISPRUDENCA E GJYKATËS
EVROPIANE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT NË LIDHJE
ME SHQIPËRINË**

2018



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

www.euro-centre.eu



**JURISPRUDENCA E GJYKATËS
EVROPIANE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT NË LIDHJE
ME SHQIPËRINË**

2018



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

LISTA E VENDIMEVE

NENI 2 - E DREJTA E JETËS

RRAPO kundër SHQIPËRISË | 25 shtator 2012.....5

CEKA kundër SHQIPËRISË | 23 tetor 2012..... 6

NENI 3 - NDALIMI I TORTURËS

KAÇIU DHE KOTORRI kundër SHQIPËRISË | 25 qershor 2013..... 7

GRORI kundër SHQIPËRISË | 7 korrik 2009.....8

DYBEKU kundër SHQIPËRISË | 18 dhjetor 2007.....9

NENI 5 - E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI

DELIJORGJI kundër SHQIPËRISË | 28 prill 2015.....10

NENI 6 - E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT

TOPALLAJ kundër SHQIPËRISË | 21 prill 2016.....11

BICI kundër SHQIPËRISË | 3 dhjetor 2015.....12

SHARRA dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 10 nëntor 2015.....12

MARKU kundër SHQIPËRISË | 15 korrik 2014.....13

LULI DHE TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 1 prill 2014.....14

DELVINA kundër SHQIPËRISË | 8 mars 2011 dhe 21 maj 2013..... 15

MANUSHAQE PUTO dhe TE TJERË kundër SHQIPËRISË | 31 korrik 2012.....16

ÇAUSH DRIZA kundër SHQIPËRISË | 15 mars 2011.....17

DELVINA kundër SHQIPËRISË | 8 mars 2011 dhe 21 maj 2013.....18

ELTARI kundër SHQIPËRISË | 8 mars 2011.....19

MISHGJONI kundër SHQIPËRISË | 7 dhjetor 2010.....20

MULLAI dhe të TJERËT kundër SHQIPËRISË | 23 mars 2010..... 21

BUSHATI dhe të TJERËT kundër SHQIPËRISË | 8 dhjetor 2009 dhe 14 shkurt 20214.....22

VRIONI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 24 mars 2009 dhe 29 shtator 2009 22

GJYLI kundër SHQIPËRISË | 29 shtator 2009.....23

HAMZARAJ kundër SHQIPËRISË | 3 shkurt 2009.....24

MARINI kundër SHQIPËRISË | 07 korrik 2008.....25

QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË | 18 nëntor 2004..... 25

BESHIRI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 22 gusht 2006.....26

GJONBOÇARI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 23 tetor 2007.....27

RAMADHI dhe të tjerë kundër SHQIPËRISË | 13 nëntor 2007..... 27

DRIZA kundër SHQIPËRISË | 13 nëntor 2007.....28

DAUTI kundër SHQIPËRISË | 3 shkurt 2009.....29

NURI kundër SHQIPËRISË | 3 shkurt 2009.....29

SHARXHI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË | 11 janar 2018..... 30

IZET HAXHIA kundër SHQIPËRISË | 5 nëntor 2013.....31

CANI kundër SHQIPËRISË | 6 mars 2012.....32

SHKALLA kundër SHQIPËRISË | 10 maj 2011.....32

HAXHIA kundër SHQIPËRISË dhe MULOSMANI kundër SHQIPËRISË | 8 tetor 2013.....36

BALLIU kundër SHQIPËRISË | 16 qershor 2005.....37

XHERAJ kundër SHQIPËRISË | 29 korrik 2008.....38

NENI 7 - NUK KA DËNIM PA LIGJ

ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË | 2 qershor 2005.....39

NENI 8 - E DREJTA PËR RESPEKTIMIN E JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE

BAJRAMI kundër SHQIPËRISË | 12 dhjetor 2006.....40

QAMA kundër SHQIPËRISË dhe ITALISË | 8 janar 2013..... 41

LISTA E SHKURTIMEVE

KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
GJK	Gjykata Kushtetuese;
GJL	Gjykata e Lartë;
KKKP	Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave;
INUK	Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar;
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
KQVL	Komisioni Qendror i Veteranëve të Luftës;
AKP	Agjencia e Kthimit të Pronave;
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

NENI 2 E DREJTA E JETËS

RRAPO kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 58555/10)

25 shtator 2012

I. Faktet kryesore

Kërkuesi Almir Rrapo është shtetas shqiptar dhe amerikan i lindur në vitin 1983. Çështja ka të bëjë me ekstradimin e tij në nëntor të vitit 2010 nga Shqipëria në SHBA, ku ai u përball me akuza për një numër krimesh të rënda, duke përfshirë anëtarësimin në grupe të organizuara të shantazhimit të cilat merreshin me vrasje, rrëmbim, shpërndarje të drogës, zjarrvënie, grabitje dhe zhvatje; disa prej këtyre veprave penale dënoheshin edhe me dënim me vdekje nga ligji amerikan. Z. Rrapo u ankua se ekstradimi i tij dhe rreziku i nënshtrimit ndaj dënimit me vdekje shkelën nenin 2, 3, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 13 të Konventës. Ai më tej u ankua se ai ishte ekstraduar në kundërshtim me masën e ndërmjetme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas Rregullës 39 të Rregullores së Gjykatës, drejtuar Qeverisë Shqiptare që të mos e ekstradonte atë, duke shkelur kështu nenin 34 të Konventës.

II. Vendimi i gjykatës

Gjykata konstatoi se nota diplomatike nga SHBA jepte garanci të mjaftueshme se kërkuesi nuk do t'i nënshtrohej dënimit me vdekje, kjo duke marrë parasysh edhe faktin se kishim të bënim me një shtet që ka një histori të gjatë respektimi të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Gjykata vlerësoi cilësinë e sigurisë së dhënë si dhe shqyrtoi pretendimet në lidhje me nenin 2, 3 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 13, për të cilat nuk konstatoi shkelje, si dhe për nenin 34 të Konventës (kërkesat individuale), për të cilin konstatoi se kishte pasur shkelje. Gjykata i akordoi kërkuesit 1,500 euro për shpenzimet gjyqësore, si dhe u shpreh se gjetja e një shkelje përbënte një dëmshpërblim të mjaftueshëm sa i takon dëmeve jomateriale të pretenduara nga kërkuesi.

CEKA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 26872/05)***23 tetor 2012****I. Faktet kryesore**

Kërkuesja, Gjyste Ceka, është një shtetase shqiptare e lindur në vitin 1963 që jeton në Mirditë. Çështja kishte të bënte me vdekjen e djalit të zonjës Ceka në paraburgimin e policisë në korrik të vitit 2004 pas arrestimit të tij nën akuzën e grabitjes. Duke u bazuar në nenin 2 dhe nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ajo pohonte në veçanti se djali i saj kishte vdekur si rezultat i keqtrajtimit nga dy policë dhe se hetimi pasues për pretendimin e saj, ka qenë i paefektshëm.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të neneve 2 (e drejta e jetës) dhe 3 (ndalimi i torturës), duke i akorduar kështu kërkueses një dëmshpërblim në shumën 10,000 euro, një shumë e cila vlerësohej si e drejtë nga gjykata. Gjykata konsideroi se nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës dhe, sipas nenit 37 § 1 (c) (çregjistrimi i kërkesave), vendosi ta heqë atë nga lista e çështjeve të saj.

NENI 3 NDALIMI I TORTURËS**KAÇIU DHE KOTORRI kundër SHQIPËRISË***(kërkesa nr. 33192/07 dhe 33194/07)***25 qershor 2013****I. Faktet kryesore**

Çështja në thelb kishte të bënte me pretendimin e z. Kaçiu se ishte rrahur brutalisht gjatë marrjes në pyetje nga policia në prill të vitit 2000, për ta bërë atë të pranojë përfshirjen e tij dhe të z. Kotorri si autorë të vrasjeve të ndodhura. Z. Kaçiu më pas u shpall fajtor për mosraportimin e krimit dhe u dënua me tre vite burgim, ndërsa z. Kotorri u shpall fajtor për vrasje me paramendim dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Duke u bazuar në nenin 3 të KEDNJ, z. Kaçiu ka theksuar se ishte rrahur keq nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje. Të dy kërkuesit gjithashtu bënë një numër kërkesash në bazë të nenit 6 për parregullsinë e procedimeve kundër tyre, veçanërisht për shkak të pranimit të deklaratave të marra nga z. Kaçiu nën presion, të cilat më parë ishin përdorur për t'i dënua ata. Z. Kaçiu më tej u ankua në bazë të nenit 6 se atij i ishte mohuar e drejta e mbrojtjes me avokat, si dhe lidhur me zgjatjen e procesit ndaj tij tej afatit të arsyeshëm.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se, qeveria shqiptare nuk kishte paraqitur asnjë shpjegim të arsyeshëm për rrahjen e pretenduar nga z. Kaçiu dhe prokurori nuk kishte urdhëruar asnjë ekzaminim mjekësor apo hetime të tjera, pavarësisht se rrahja e kërkuesit ishte e një shkalle të tillë, sa ai duhet të mbahej nga oficerët e policisë për në sallën e gjyqit. Sjellja e dënueshme e oficerëve të policisë për një periudhë të konsiderueshme të kohës, kishte sjellë si pasojë dhënien e deklarimeve vetëinkriminuese nga kërkuesi për veten dhe kërkuesin e dytë, në mënyrë që t'i jepte fund dhimbjes mendore dhe fizike që po përjetonte. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh se këto sjellje përbënin torturë dhe rrjedhimisht kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës), si dhe nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt ligjor). Gjithashtu, Gjykata i akordoi një dëmshpërblim prej 15,600 eurosh z. Kaçiu, ndërsa për sa i përket z. Kotorri, konstatimi i shkeljeve nga ana e Gjykatës përbënte dëmshpërblim moral të mjaftueshëm Gjykata theksoi se forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit do të ishte një gjykim i ri, ose rihapja e procesit penal, nëse do të kërkohej nga kërkuesit.

GRORI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 25336/04)***7 korrik 2009****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi Arben Grori, është një shtetas shqiptar i cili aktualisht ndodhet në burgun e Sigurisë së Lartë në Peqin duke vuajtur një dënim prej 15 vitesh burg për trafikim ndërkombëtar të narkotikëve dhe një dënim të përjetshëm për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit - veprat e fundit janë kryer në territorin Italian. Në gusht 2004 ai u diagnostikua me sklerozë të shumëfishtë dhe mjekët raportuan se sëmundja e tij mund t'i shkaktonte shok, dëmtim të organeve, paaftësi të përhershme ose vdekje. Z. Grori ka marrë rregullisht trajtimin e duhur mjekësor për sëmundjen e tij vetëm nga 17 qershori 2008 e në vazhdim. Ai u ankua se kishte marrë trajtim mjekësor të papërshtatshëm në burg, si dhe u ankua në lidhje me paligjshmërinë e paraburgimit të tij, për vërtetimin dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit të përjetshëm të caktuar nga gjykatat italiane në mungesë të tij. Ai mbështetej në nenet 3, 5 § 1, 6 § 1, 7 të Konventës dhe në nenin 2 të Protokollit nr. 7. Ai gjithashtu u ankua se transferimi i tij në një spital civil në janar 2008 kishte ndodhur me vonesë, duke shkelur nenin 34 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vuri në dukje se midis prillit 2005 dhe janarit 2008 Z. Grori ishte lënë për kohë të gjatë pa trajtim të përshtatshëm mjekësor. Raporti i fundit mjekësor mbi gjendjen e tij shëndetësore kishte konfirmuar se progresi i sëmundjes kishte ardhur prej mungesës së kujdesit mjekësor. Gjykata arriti në përfundimin se të gjitha veprimet e ndërmarra ndaj tij, si dhe vuajtja fizike përbënin trajtim degradues për kërkuesin, duke shkelur kështu nenin 3 të Konventës. Gjykata konstatoi se baza ligjore e gjetur nga GJL për të legjitimuar ndalimin e z. Grori nuk mund të përmbushte kriteret e ligjshmërisë, përse i përket paraburgimit të kërkuesit dhe vleftësimit të vendimit penal të formës së prerë, marrë nga Gjykata italiane e Apelit kundër tij. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ndërmjet majit 2002 dhe dhjetorit 2003, z. Grori nuk ishte arrestuar në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj dhe për këtë arsye kishte shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata konstatoi se, urdhri i gjykatës vendase për të dërguar kërkuesin në spital për ekzaminim mjekësor ishte shkelur me 17 ditë jo për pengesa objektive, prandaj konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 34. Gjykata u shpreh se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej më vete sipas nenit 6 § 1 ankesa për paligjshmërinë e procesit në lidhje me vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit të dhënë në Itali.

DYBEKU kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 41153/06)***18 dhjetor 2007****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Ilir Dybeku, është një shtetas shqiptar i cili nga viti 1996 e tutje ka vuajtur nga skizofrenia kronike paranojake. Për shumë vite ai ka marrë trajtim në spitale të ndryshme psikiatrike në Shqipëri. Më 24 gusht 2002, z. Dybeku u arrestua dhe akuzua për vrasje dhe posedim ilegal të eksplozivëve. Ai u vendos në paraburgimin e Komisarariatit të Policisë Durrës, ku ndau qelinë me një numër të papërcaktuar të burgosurish deri më 27 maj 2003, kur gjykata vendase e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Që nga dhjetori 2003, kërkuesi ka qenë në tri burgje të ndryshme, ku ka ndarë qelinë me të burgosur të tjerë dhe është trajtuar si një i burgosur i zakonshëm, pavarësisht nga gjendja e tij shëndetësore. Atij nuk i është dhënë ndihma dhe trajtimi i duhur mjekësor, çka ka përkeqësuar gjendjen e tij, si dhe i është mohuar vazhdimisht kërkesa për të pasur një ri-ekzaminim mjekësor. Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 3, se mohimi i ndihmës dhe ekzaminimeve mjekësore kishte përbërë torturë ndaj tij, si dhe në bazë të nenit 6, për parregullsinë e proceseve gjyqësore.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se, që nga viti 2002 z. Dybeku nuk i ishte ushtruar asnjë ekzaminim mjekësor për të parë fazën e përparimit ose jo, të sëmundjes së tij. Gjithashtu, gjykata pranoi se gjendja psikologjike e kërkuesit e bënte atë më vulnerabël se të burgosurit e tjerë, duke i shkaktuar atij ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Gjykata, duke marrë parasysh raportin e Komitetit të Parandalimit të Torturës në Këshillin e Evropës, konkludoi se trajtimi që i ishte bërë kërkuesit kishte qenë çnjerëzor dhe degradues, duke sjellë kështu shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 3 i Konventës. Në lidhje me nenin 6, Gjykata vërejti se Konventa nuk garanton të drejtën e lirit me kusht ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me një regjim burgimi të veçantë, për rrjedhojë Gjykata u shpreh se kërkesa ishte e pabazuar në nenin 6.

NENI 5 E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI**DELIJORGJI kundër SHQIPËRISE***(kërkesa nr. 6858/11)***28 prill 2015****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Mihal Delijorgji, ishte administratori i një kompanie private që merrej me demonstrimin e armëve, kur në mars të vitit 2008, në një prej punishteve të kompanisë ndodhi një shpërthim masiv që i mori jetën 26 personave dhe plagosi 265 të tjerë. Z. Delijorgji së bashku me 28 persona të tjerë u ngarkua me akuzën e vrasjes dhe shkeljes së rregullave të ekspozivëve. Kërkuesi u vendos në paraburgim 2 ditë pas ngjarjes dhe çështja kundër tij u çua në Gjykatën e Lartë, pasi një ndër të bashkakuarët ishte ministër i qeverisë së asaj kohe; ndërsa në qershor 2009 iu dërgua Gjykatës së Rrethit Tiranë. Që prej korrikut 2010, z. Delijorgji ka kërkuar 3 herë lirim të tij nga paraburgimi për shkak të përfundimit të afatit, derisa më në fund në shkurt 2011 ai u dënua me arrest shtëpie. Ai u ankua për shkelje të nenit 5 § 1 dhe 5 § 4 të Konventës, për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij “në pritje të gjykimit” dhe kohës që iu desh autoriteteve të shqyrtonin kërkesën e tij të parë për lirim.

II. Vendimi i Gjykatës

Duke marrë në shqyrtim kohën e kaluar në paraburgim si dhe qëllimin e nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri), gjykata u shpreh se neni 5 § 1 nuk lejon heqjen e lirisë në mënyrë arbitrare; duke qenë se afati i paraburgimit kishte përfunduar, nuk kishte arsye për të vendosur arrest shtëpie për kërkuesin dhe nga ana tjetër, lënia e tij në paraburgim vazhdonte të ishte e paligjshme. Gjykata u shpreh se kushtet për heqjen e lirisë sipas ligjit të brendshëm duhet të përcaktohen qartë dhe ligji duhet të jetë i parashikueshëm në zbatimin dhe pasojat që ai sjell. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës, për periudhën nga 24 nëntori 2010 deri në 12 mars 2012. Në lidhje me nenin 5 § 1, Gjykata ia atribuoi vonesat shtetit, ndërsa u shpreh se neni 5 § 4 i Konventës kërkon që kërkesa për lirim të trajtohet me shpejtësi, çka nuk ishte respektuar nga shteti. Bazuar në nenin 41, Gjykata konkludoi për një dëmshpërblim prej 15,600 eurosh për dëmin jomaterial të shkaktuar ndaj kërkuesit.

NENI 6 E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT**TOPALLAJ kundër SHQIPËRISE***(kërkesa nr. 32913/03)***21 prill 2016****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Topallaj, lidhi dy marrëveshje me një nga pronarët e një grupi tokash që kompania e z. Topallaj të ndihmonte pronarët e tokave në procesin e privatizimit të instalimeve dhe të tankeve të karburantit në tokë. Në maj të vitit 1996 i njëjti pronar tokash përfundoi një kontratë shitjeje të noterizuar me Z. Topallaj për shitjen e pothuajse të gjitha serbatorëve dhe instalimeve të karburantit. Pas përfundimit të këtyre kontratave, të gjithë pronarët e tokës e caktuan z. Topallaj që të vepronin në emër të tyre në procedurat lidhur me mbrojtjen e të drejtave të tyre pronësore. Në vitin 2002 dhe 2005, pronarët e tokës morën masa kundër z. Topallaj duke kërkuar anulimin e kontratave të lidhura që në fillim. Në prill 2006, gjykata e qarkut i shpalli ato kontrata të pavlefshme, duke arsyetuar se ato ishin lidhur në mënyrë fiktive për sa kohë prona në fjalë ishte gjatë gjithë kohës në administrim nga Shteti dhe asnjë e drejtë pronësie nuk ishte transferuar tek pronarët e tokës. Ankesat e z. Topallaj u refuzuan, vendimi përfundimtar u dha nga Gjykata Kushtetuese në nëntor 2010. Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 6 § 1, z. Topallaj u ankua për kohëzgjatjen e procedurave lidhur me të drejtat pronësore të pronarëve. Ai gjithashtu u ankua se nuk kishte pasur asnjë mjet ankimi efektiv në dispozicion në lidhje me ankesën, duke shkelur kështu nenin 13. Gjithashtu pati pretendime për nenin 46 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se, periudha totale gjatë së cilës ishin zhvilluar procedurat në lidhje me të drejtat pronësore të pronarëve të grupit të tokave në fjalë, ishte 9 vite, 4 muaj e 8 ditë, një periudhë kjo dukshëm shumë e gjatë. Gjithashtu, çështja ishte kthyer disa herë për rigjykim nga njëra gjykatë në tjetrën, duke shkaktuar kështu një zvarritje të procedurave. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1, sa i takon kohëzgjatjes së proceseve nga 12 maji 2000 deri më 20 shtator 2009. Gjithashtu, në lidhje me nenin 13, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje, duke qenë se në Shqipëri ai nuk kishte disponuar mjetet e nevojshme për një akim efektiv. Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) si dhe i akordoi kërkuesit një dëmshpërblim prej 1,000 eurosh për dëmin jomaterial të shkaktuar ndaj tij.

BICI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 11006/06)***3 dhjetor 2015****I. Faktet kryesore**

Në shtator 1996, gjykata e shkallës së parë pranoi se z. Bici kishte trashëguar të drejtat pronësore për një tokë bujqësore, e cila ishte në pronësi të babait të tij dhe ishte shpronësuar nën regjimin komunist. Z. Bici paraqiti një kërkesë në KKKP që kërkonte njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës. Në korrik 2008 Komisioni e ktheu kërkesën tek z. Bici, duke deklaruar se nuk mund të merrej asnjë vendim mbi vendimin e gjykatës së qarkut të vitit 1996 dhe se dispozitat përkatëse ligjore, të cilat parashikonin njohjen e të drejtave pronësore në një rast të tillë si i z. Bici, ishin shfuqizuar. Duke u bazuar veçanërisht në nenin 6 § 1 të KED-NJ, z. Bici u ankua se kohëzgjatja e procedurave para Komisionit ishte e paarsyeshme dhe e pajustificueshme. Gjithashtu, kërkesi u ankua dhe në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata shqyrtoi rastin në fjalë, duke konstatuar se procedurat për kthimin dhe/ose kompensimin e pronës së z. Bici kishin zgjatur në total për 11 vite, 9 muaj dhe 18, një kohë kjo tepër e gjatë dhe e pajustificueshme. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt), sa i takon kohëzgjatjes së procedurave, duke i akorduar kërkesit 7 000 euro dëmshpërblim për dëmin jomaterial si dhe 850 euro për shpenzimet gjyqësore. Sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, rezultonte që kërkesi nuk kishte të drejta për të bërë kërkesa legjitime për kthimin e pronës në fjalë dhe për këtë arsye nuk kishim të bënim me “posedim” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Rrjedhimisht, kjo ankesë ishte në kundërshtim me Konventën *ratione materiae* dhe duhet të refuzohej në përputhje me nenin 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

SHARRA dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12)***10 nëntor 2015****I. Faktet kryesore**

Kërkesit janë znj. Sharra dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të një sasive tokash në Vlorë. Në dhjetor 1994, KKKP Vlorë i njohu kërkeses dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë, titullin e

pronësisë mbi një sipërfaqe tokash prej 46 500 m², prej të cilave 900 m² iu kthyen kërkesve. Pjesa tjetër e sipërfaqes do t'i kompesohej kërkesve në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Ndërsa përsa i përket një prone me sipërfaqe 13 750 m², Komisioni nuk arriti t'i përcaktonte asaj kufinj të, kështu që nuk u shpreh për të drejtat pronësore mbi këtë sipërfaqe. Deri në momentin e dërgimit të çështjes në GJEDNJ, nuk ishte bërë asnjë kompesim ndaj kërkesve. Ata pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1, 13 dhe nenit 1 të Protokollit. 1 të Konventës, si dhe kërkuan shpërblim të drejtë në bazë të nenit 41.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin mbi nenin 6 § 1, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje sa i takon moszbatimit të vendimeve të autoriteteve lokale, ndërkohë që e shpalli të papranueshme kërkesën për shkelje të nenit 6 në kuptim të tejzgjatjes së procedurave. Gjithashtu, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata u shpreh se moszbatimi i vendimit të Komisionit kishte çenuar të drejtën e kërkesve për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e tyre, duke përbërë kështu shkelje të Konventës, ndërsa në kërkesën nr. 25038/08, Gjykata arsyetoi se, pretendimi i kërkeses për tokën me sipërfaqe 13 750 m² nuk ishte në kuptim të këtij neni, pasi Komisioni nuk ia kishte njohur të drejtën e pronësisë mbi truallin në fjalë. Për rrjedhojë, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën në bazë të nenit 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës. Gjykata u shpreh më tej për shkelje të nenit 13 (e drejta për ankim efektiv). Sa i takon shpërblimit të drejtë, që ishte thelbi i këtij vendimi, bazuar në nenin 41 Gjykata arsyetoi se, për shkak të sistemit joefektiv të kompesimit të pronave dhe faktit që kishin kaluar 8 deri në 11 vite qëkur kërkesve iu ishte akorduar e drejta për kompesim, Gjykata e mendoi të arsyeshme t'i akordonte atyre një shumë përfundimtare dhe të drejtë për çështjen e tyre. Gjykata vendosi se do t'a përcaktonte dëmin material në bazë të hartave të vlerësimit të pronës të vitit 2008. Bazuar në këtë, Gjykata i akordoi znj. Sharra 191 400 euro në kuadër të dëmit material, si dhe 850 euro për shpenzimet gjyqësore.

MARKU kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 54710/12)***15 korrik 2014****I. Faktet kryesore**

Kërkesi, z. Marku kishte aplikuar në KQVL në vitin 2002 që t'i njihej statusi “veteran lufte”, i cili do t'i jepte të drejtën për përfitime financiare. Në shkurt të vitit 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë e njohu statusin e tij si veteran lufte dhe ky vendim u miratua në apel në shkurt 2007. Megjithatë, kërkesa e tij pasuese që kërkonte që Komisioni Qendror t'i paguante përfitimet financiare, u hodh poshtë nga Gjykata e Qarkut në tetor 2008, me arsyetimin se vendimi fillestar i vitit 2006 ishte i një natyre deklarative dhe vetëm Komisioni Qendror mund të

njohë me kompetencë statusin “veteran lufte” të një personi. Z. Marku e apeloj vendimin në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, por këto ankesa të gjitha u hodhën poshtë. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, z. Marku u ankua se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë në shkurt 2006, të mbështetur nga Gjykata e Apelit në shkurt 2007, sa i përket njohjes së statusit të tij si veteran lufte.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata mori në shqyrtim rastin, duke u bazuar në faktin se kërkuesi nuk kishte mundur të gëzonte të drejtën e tij për t’iu drejtuar Gjykatës, dhe se pavarësisht se ishte marrë një vendim gjykate në favor të tij, ai nuk kishte qenë në gjendje të niste procedurat për të marrë një vendim përfundimtar lidhur me statusin e tij si veteran lufte. Në këtë mënyrë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

LULI DHE TË TJERËT kundër SHQIPËRISË

(kërkesat nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/2, 31355/09)

1 prill 2014

I. Faktet kryesore

Kërkuetit janë dhjetë shtetas shqiptarë, që kanë lindur ndërmjet viteve 1921 dhe 1968. Ata u ankuan në veçanti në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve civile për njohjen e të drejtave të tyre pronësore tej afatit të arsyeshëm. Ata pretenduan për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata hodhi poshtë kërkesat nr. 3129/2 dhe 31355/09, ndërsa vendosi për shkelje të nenit 6 për sa i përket kërkesave të tjera. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se, kohëzgjatja e tepërt e procedurave po bëhej një mangësi serioze në procedurat gjyqësore në Shqipëri dhe se kjo mund të çonte më pas në një numër të madh kërkesash të tjera të bazuara në po të njëjtin nen. Në rastet kur Gjykata konstaton një deficiençë në sistemin ligjor të një vendi, autoriteteve të atij i shteti u lind detyra të ndërmarrin, brenda një periudhe të caktuar kohe, masat e nevojshme për kompesim, në përputhje me parimin e subsidiaritetit në Konventë. Në këtë mënyrë, Gjykatës nuk do t’i duhet të konstatojë të njëjtat shkelje në një sërë çështjesh të ngjashme me njëra-tjetrën. Ajo konstatoi shkelje të nenit 46 dhe bazuar në nenin 41, i akordoi kërkuetit një dëmshpërblim prej 1 500 eurosh për dëmin jomaterial dhe 1 500 euro për shpenzimet gjyqësore, për kërkesat e pranuar prej saj.

DELVINA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 49106/06 dhe 19106/06)

8 mars 2011 dhe 21 maj 2013

I. Faktet kryesore

Kërkueti, z. Delvina ishte trashëgimtari i një parcele toke, e cila i ishte konfiskuar babait të tij nga regjimi komunist pa kompesim. Mbi të u ndërtua një ndërtesë, të cilën më vonë e bleu Ambasada Italiane. Në korrik 1999, KKKP në Tiranë i njohu kërkuetit të drejtën mbi pronën dhe vendosi se Qeveria Italiane duhet të paguante qira mbi tokën ose ta riblinte atë me marrëveshje. Kërkueti u pajis me certifikatë regjistrimi pasurie lëshuar nga ZRPP. Në qershor 2004 Gjykata e Rrethit Tiranë, pas padisë së ngritur nga kërkueti anuloi vendimin e KKKP në lidhje me kthimin fizik të pronës dhe vendosi që kërkueti të kompesohej për sipërfaqen në një nga mënyrat e parashikuara me ligj. Të njëjtin qëndrim mbajtën dhe Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese. Kërkueti pretendoi për shkelje të nenit 6 § 1, nenit 13, dhe nenit 1 të Protokollit nr.1, si dhe kërkoi shpërblim të drejtë në kuadër të nenit 41 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin mbi nenin 6, Gjykata konstatoi se pavarësisht vendimit të Gjykatës së Lartë se kërkueti duhet të kompesohej për pronat, autoritetet shqiptare nuk ndërmorën asnjë masë për të zbatuar atë vendim. Gjykata u shpreh se, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë cenonte të drejtën e kërkuetit për akses në gjykatë, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6. Sa i takon nenit 13, Gjykata arsyetoi se kërkueti nuk kishte pasur një mjet efektiv ligjor që t’i mundësonte atij të zbatonte të drejtën e kompesimit. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 13, marrë së bashku me nenin 6. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata theksoi se pamundësia e kërkuetit për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë përbente ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzim të qetë të pronës. Si përfundim, Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës. Në lidhje me nenin 41, në kuadër të një shpërblimi të drejtë, Gjykata i akordoi kërkuetit 2,022,400 euro si dëm monetar dhe 3,500 euro në kuadër të shpenzimeve gjyqësore.

MANUSHAQE PUTO dhe TE TJERË kundër SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 604/07, 43628/07, 46684/07, 34770/09)***31 korrik 2012****I. Faktet kryesore**

Rasti kishte të bënte me kërkesat e 20 shtetasve shqiptarë që, pavarësisht se titulli i tyre i trashëgimisë për parcelat e tokës ishte njohur nga autoritetet, vendimet administrative përfundimtare që u japin atyre kompensim në një nga mënyrat e parashikuara me ligj në vend të kthimit, nuk ishin zbatuar asnjëherë. Aktualisht janë të pranishëm 80 raste të ngjashme përpara Gjykatës. Kërkuesit u mbështetën në nenin 6 § 1, nenin 13, nenin 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata u shpreh se çështja sillte një mungesë zbatueshmërie të vendimeve nga ana e shtetit shqiptar, për një periudhë kohore prej 15 deri në 17 vite. Ajo arsyetoi se shteti nuk mund të përdorte mungesën e disponueshmërisë së fondeve si justifikim për mosshlyerjen e borxheve të vendimeve. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të marrë së bashku me nenin 6, sa i takon kohëzgjatjes së procedurave dhe shkeljes së të drejtës së pronës. Në lidhje me pretendimin për nenin 13, Gjykata u shpreh se shteti nuk dispononte asnjë mjet efektiv për të kompesuar tejzgjatjen e moszbatimit të procedurave administrative, si rrjedhojë konstatoi shkelje të nenit 13. Në lidhje me nenin 46, Gjykata theksoi se shkeljet që ajo konstatoi gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, ishin shkelje të cilat preknin një numër të madh njerëzish në Shqipëri dhe se, përveç indikacioneve për të marr masa, në shqyrtimin e kësaj çështjeje u gjetën të njëjtat shkelje si në gjykime të mëparshme. Gjykata e vlerësoi të nevojshme për të aplikuar procedurën e gjykimit pilot në këtë rast. Ajo i kërkoi autoriteteve shqiptare të fillojnë të krijojnë mundësi të tjera të kompesimit, për të mos aplikuar gjithmonë kompesimin financiar. Gjithashtu, sa i takon procedurave lidhur me kërkesa të tjera të ngjashme kundër Shqipërisë, Gjykata vendosi të shtyjë trajtimin e tyre deri në kohën kur vendimi në fjalë të bëhet përfundimtar.

ÇAUSH DRIZA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 10810/05)***15 mars 2011****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Caush Driza, kishte marrë një vendim gjyqësor që deklaronte shtetëzimin e paligjshëm të pronës së babait të tij dhe urdhëronte kthimin e saj. Meqënëse autoritetet nuk ishin në gjendje të kthenin pronën origjinale, kërkuesit iu dhanë dy parcela të tjera të toke, me një vendim të mbështetur nga një komision për kthimin dhe kompensimin e pronës. Megjithatë, ai nuk mundi të merrte në posedim pronën sepse parcelat ishin të zëna nga palë të treta. Kërkuesit i ishte atribuar një kompensim, por nuk ishte paguar. Ai u ankua bazuar në nenin 6, se anulimi i vendimit përfundimtar sipas procedurës së shqyrtimit mbikqyrës, ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk ishin të paanshme, si dhe pretendoi për shkelje të nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se ishte cenuar paanshmëria subjektive e GJL, duke qenë se vetë Kryetari i saj kishte kërkuar nisjen e procedurave vlerësuese dhe nga ana tjetër, kishte qenë pjesë e trupit gjykues që kishte shqyrtuar kërkesën. Askush nuk mund të jetë edhe paditës edhe gjyqtar për të njëjtën çështje, kështu që Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me pretendimin për nenin 13 marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata u shpreh se autoritetet nuk kishin arritur të mundësonin një procedurë të përshtatshme për kompesimin e pronës. Si rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 13. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata u shpreh se autoritetet kishin dështuar për vite me rradhë të zbatonin vendimet e gjykatave, duke përbërë kështu një cenim të së drejtës së kërkuesve për gëzim paqësor të pronave dhe se mungesa e fondeve nuk mund të justifikonte dështimin e shtetit në zbatimin e një vendimi përfundimtar. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

DELVINA kundër SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 49106/06 dhe nr. 19106/06)***8 mars 2011 dhe 21 maj 2013****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Delvina ishte trashëgimtari i një parcele toke, e cila i ishte konfiskuar babait të tij nga regjimi komunist pa kompesim. Mbi të u ndërtua një ndërtesë, të cilën më vonë e bleu Ambasada Italiane. Në korrik 1999, KKKP në Tiranë i njohu kërkuesit të drejtën mbi pronën dhe vendosi se Qeveria Italiane duhet të paguante qira mbi tokën ose ta riblinte atë me marrëveshje. Kërkuesi u pajisën me certifikatë regjistrimi pasurie lëshuar nga ZRPP. Në qershor 2004 Gjykata e Rrethit Tiranë, pas padisë së ngritur nga kërkuesi anuloi vendimin e KKKP në lidhje me kthimin fizik të pronës dhe vendosi që kërkuesi të kompesohej për sipërfaqen në një nga mënyrat e parashikuara me ligj. Të njëjtin qëndrim mbajtën dhe Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese. Kërkuesi pretendoi për shkelje të nenit 6 § 1, nenit 13, dhe nenit 1 të Protokollit nr.1, si dhe kërkoi shpërblim të drejtë në kuadër të nenit 41 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin mbi nenin 6, Gjykata konstatoi se pavarësisht vendimit të Gjykatës së Lartë se kërkuesi duhet të kompesohej për pronat, autoritetet shqiptare nuk ndërmorën asnjë masë për të zbatuar atë vendim. Gjykata u shpreh se, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë cenonte të drejtën e kërkuesit për akses në gjykatë, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6. Sa i takon nenit 13, Gjykata arsyetoi se kërkuesi nuk kishte pasur një mjet efektiv ligjor që t'i mundësonte atij të zbatonte të drejtën e kompesimit. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 13, marrë së bashku me nenin 6. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata theksoi se pamundësia e kërkuesve për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë përbente ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzim të qetë të pronës. Si përfundim, Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës. Në lidhje me nenin 41, në kuadër të një shpërblimi të drejtë, Gjykata i akordoi kërkuesit 2 022 400 euro si dëmshpërblim material dhe 3 500 euro në kuadër të shpenzimeve gjyqësore.

ELTARI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr 16530/06)***8 mars 2011****I. Faktet kryesore**

Kërkueses dhe trashëgimtarëve të tjerë, në vitin 1994 iu njoh nga KKKP Vlorë titulli i pronësisë mbi një sipërfaqe trualli. Meqënëse kthimi fizik ishte i pamundur sepse trualli ishte i zënë, ata do të kompesoheshin me një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Në 1997, kërkuesja nënshkroi një kontratë me AKP Vlorë, për blerjen e një farmacie që ndodhej në sipërfaqen e truallit që ajo kishte trashëguar. Çështja shkoi në gjyq, pasi u pretendua paligjshmëria e kontratës; Gjykata e Rrethit Vlorë deklaroi nul pjesën e vendimit sa i takonte sipërfaqes së truallit që gjendej në tokën e trashëguar nga kërkuesja, duke pretenduar se sipërfaqja ishte pronë private e shpronësuar në 1920 dhe nuk mund të zbatohet mbi të rregullit për kompesimin, për sa kohë trualli nuk ishte shpronësuar gjatë regjimit komunist. Kërkesat e znj. Eltari u hodhën poshtë edhe nga Apeli, GJL dhe GJK. Pas një kërkesë për riinterpretim të vendimit të vitit 1999, Gjykata e Vlorës u shpreh se kërkueses nuk mund ti njihej e drejta për pronën por do të kompesohej për sipërfaqen e trashëguar. Megjithatë, ky kompesim nuk u bë, prandaj kërkuesja çoi çështjen në GJEDNJ duke pretenduar shkelje të nenit 6, 13, nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të neneve 41 dhe 46 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se, mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave vendase nga autoritetet shtetërore ishte cënim i së drejtës për të pasur akses në drejtësi, duke përbërë kështu haptazi shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt). Në lidhje me nenin 13, Gjykata vlerësoi se nuk ishte marrë asnjë masë efektive nga ana e autoriteteve për ekzekutimin e vendimit të gjykatës vendase, në favor të kërkueses. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për ankim efektiv). Sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës, Gjykata arsyetoi se mosekzekutimi i vendimit të gjykatës vendase përbente cënim të së drejtës së kërkueses për gëzimin e pronës, rrjedhimisht kishte pasur shkelje të këtij neni (mbrojtja e pronës). Së fundi, lidhur me nenin 41 (shpërblimi i drejtë) dhe 46 (fuqia detyruese e vendimeve), Gjykata konkludoi se nuk ishte në gjendje të merrte një vendim, duke i lënë mundësi palëve të zgjidhnin situatën me marrëveshje.

MISHGJONI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 18381.05)***7 dhjetor 2010****I. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Mishgjoni, ishte gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Vlorë, kur ndaj saj u hap një procedim disiplinor nga KLD, mbi bazën e të cilit, në janar 2002 prokuroria inicioi një procedim penal kundër kërkueses, veprim që çoi në pezullimin e saj nga puna. Në prill 2002 hetimi penal ndaloi për shkak të mungesës së fakteve, por në korrik 2002, KLD e largoi atë nga puna për shkelje flagrante të disiplinës profesionale. Pas ndërprerjes së procedimit penal në prill 2002, kërkuesja kërkoi nga KLD dhe Ministri i Drejtësisë pagesën e pagave të munguara gjatë periudhës së pezullimit. Kjo kërkesë u mbështet nga Gjykata e Vlorës por u rrëzua nga Apeli dhe Gjykata e Lartë, si dhe nga Gjykata Kushtetuese në vazhdim. Ajo pretendoi për shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 marrë së bashku me nenin 6 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes theksoi se, procedurat penale ndaj kërkueses kishin zgjatur për një periudhë kohore mjaft të gjatë, rreth 8 vite dhe kjo vonesë nuk vinte si shkak i kërkueses apo nga kompleksiteti i çështjes. Ajo theksoi se, një vonesë prej thujse 4 vitesh për të shqyrtuar sërish çështjen, nuk justifikohet si 'kohë e arsyeshme' në bazë të nenit 6. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me nenin 13, Gjykata u shpreh se kërkuesja nuk kishte pasur në dispozicion asnjë mjet efektiv ankimi, duke iu cënuar kështu të drejtat e mbrojtura nga ky nen. Si rrjedhojë, ajo u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13. Gjithashtu, gjykata i akordoi kërkueses 2,000 euro për dëmin pasuror dhe 1,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

PUTO dhe të TJERËT kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 604/07)***20 korrik 2010****I. Faktet kryesore**

Në qershor 1994, KKKP u njohu kërkuesve titullin e pronësisë të një sipërfaqe trualli dhe ndërtesës mbi të dhe i caktoi një dëmshpërblim në vlerë monetare meqë ndërtesa nuk ishte përfunduar ende. Në maj 2000, Gjykata e Sarandës lëshoi një vendim për ekzekutimin e vendimit të KKKP. Kërkuesit i dërguan disa herë shkresa Ministrisë së Drejtësisë, por nuk morën përgjigje deri në momentin që çështja u dërgua në GJEDNJ. Pas këtij momenti, autoritetet u shprehën se në prill 2002, kërkuesit e kishin shitur parcelën dhe ndërtesën tek

persona të tretë dhe në korrik 2008, ZVRPP Sarandë vërtetoi se prona i ishte transferuar personave të tretë mbi bazën e një kontrate shitblerjeje. Kërkuesit pretenduan për shkelje të nenit 6, nenit 13 lidhur me nenin 6, nenit 1 të Protokollit nr. 1 si dhe nenit 41.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se, mosekzekutimi i vendimit të gjykatave vendase nga ana e autoriteteve, cënon të drejtën e kërkuesve për akses në drejtësi, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me nenin 13, marrë së bashku me nenin 6, Gjykata theksoi se kërkuesit nuk kishin pasur në dispozicion asnjë mjet efektiv për të vënë në zbatim vendimet e gjykatës, duke përbërë kështu shkelje të këtij neni. Sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1, Gjykata arsyetoi se, mosekzekutimi i vendimit të gjykatës vendase, i kishte cënuar kërkuesit të drejtën për gëzimin e pronës së tyre, duke përbërë kështu shkelje të këtij neni. Gjykata konkludoi në bazë të nenit 41, se kërkuesve do ti akordoheshin 65,000 euro shpërblim për dëm material dhe jomaterial dhe 2,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

MULLAI dhe të TJERËT kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 9074/07)***23 mars 2010****I. Faktet kryesore**

Kërkuesit janë shtatë shtetas shqiptarë, që jetojnë në Shqipëri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Itali dhe një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar sipas ligjit shqiptar dhe e regjistruar në Tiranë. Rasti ka të bëjë me një mosmarrëveshje në lidhje me një leje ndërtimi. Kërkuesit pohonin në veçanti se autoritetet nuk kishin zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë në të cilin leja e ndërtimit ishte shpallur e vlefshme dhe më pas kishin shkelur parimin e sigurisë juridike duke shuar atë vendim përfundimtar. Ata u mbështetën në nenin 6 § 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se, tri seritë e procedurave gjyqësore ishin kryer në një hapësirë kohore prej thujse 10 vitesh, një periudhë kjo tepër e gjatë dhe jashtë afatit të një 'kohe të arsyeshme'. Nga ana tjetër, ekzistenca e disa procedimeve paralele në shkallë të ndryshme është në kundërshtim me shtetin e së drejtës dhe cenonte parimin e sigurisë juridike. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh për shkelje të nenit 6 § 1. Sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata u shpreh se kërkuesit dhe shoqëria kërkuese nuk ishin lejuar për shumë vite të gëzonin pronën e tyre dhe prishja e vilës së kërkuesve prej lejes së ndërtimit të dhënë ndaj shoqërisë ishte e jashtëligjshme, duke përbërë kështu shkelje të këtij neni.

BUSHATI dhe të TJERËT kundër SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 6397/04 dhe nr. 6397/04)***8 dhjetor 2009 dhe 14 shkurt 20214****I. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin shtetas shqiptarë dhe banues në Shkodër. Në vitin 1994, KKKP Durrës i njo-hu atyre të drejtën e pronësisë mbi një pronë në bregdet të trashëguar nga një i afërm i tyre, por toka ishte e zënë nga posedues të paligjshëm dhe ata nuk mundën të ushtronin të drejtat e tyre të pronësisë. Në vitin 1995, Gjykata e Rrethit Durrës konfirmoi të drejtat e pronësisë së kërkuesve dhe urdhëroi poseduesit të lironin truallin. Ata u ankuan në bazë të nenit 6 § 1 si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, për moszbatim nga ana e autoriteteve të një vendimi Gjykatë, duke cënuar kështu edhe të drejtat e tyre pronësore. Ata gjithashtu kërkuan një shpërblim të drejtë nga Gjykata, bazuar në nenin 41 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 6 § 1, Gjykata u shpreh se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një detyrim pozitiv të Shteteve palë të KEDNJ, dhe se përmbaruesit duhet të kishin marrë masa të menjëhershme për të zbatuar vendimin. Moszbatimi i vendimit nga ana e autoriteteve kishte përbërë shkelje të nenit 6 § 1. Sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1, Gjykata arsyetoi se moszbatimi i vendimit të gjykatës vendase kishte çuar në cënim të së drejtës së kërkuesve për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e tyre, duke shkelur kështu këtë nen. Sa i takon shpërblimit të drejtë, bazuar në nenin 41 të Konventës, Gjykata u shpreh se pretendimi i kërkuesve për shpërblim të dëmit monetar ishte i ekzagjëruar, dhe ra dakort me deklaratën uniterale të autoriteteve shqiptare, duke i akorduar një dëmshpërblim prej 11,500 euro.

VRIONI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 35720/04 dhe nr. 2114/03)***24 mars 2009 dhe 29 shtator 2009****I. Faktet kryesore**

Kërkuesit janë trashëgimtarë të një trualli toke të trashëguar nga gjyshi i tyre, për të cilën KKKP i njo-hu titullin e pronësisë në vitin 1999. Toka ishte zënë nga Ambasada Italiane sipas një marrëveshjeje ndërshtetërore, dhe sipas Ambasadës, konflikti i kërkuesve dhe shtetit shqiptar duhet të zgjidhej mes tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi se toka ishte

pjesë e mjediseve të Ambasadës Italiane, kështu që kërkuesit duhet të kompesoheshin për të në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Ky vendim u hodh poshtë nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, Gjykata e Lartë kishte kërkuar rishikim për anulimin e vendimit të formës së prerë të shkurtit 1998. Kërkuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1, nenit 1 të Protokollit nr. 1, nenit 13, si dhe nenit 46 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka marrë çështjen në shqyrtim, duke arsyetuar se mosekzekutimi i një vendimi gjyqësor i formës së prerë cenon të drejtën e kërkuesit për akses në gjykatë. Nga ana tjetër, proceset kishin zgjatur për një periudhë kohore prej 11 vitesh, jashtë çdo “kohe të arsyeshme”. Gjithashtu, Gjykata u shpreh se përmes rishikimit për të anuluar vendimin e formës së prerë të shkurtit 1998, GJL bëri të pavlefshëm një proces gjyqësor i cili kishte fuqinë *res judicata*. Si rrjedhojë, Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me pretendimin për nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vërejti se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë nga një anë dhe anulimi i një vendimi përfundimtar nga ana tjetër, kishin cënuar të drejtën e kërkuesve për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e tyre, duke përbërë kështu shkelje të këtij neni. Sa i takon pretendimit mbi nenin 13 marrë së bashku me nenin 1, Gjykata u shpreh se kërkuesit nuk kishin pasur mundësinë e mbrojtjes së të drejtës së tyre të pronës me mjete efektive, duke konstatuar kështu shkelje të nenit 13. Në lidhje me zbatimin e nenit 46, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje, dhe në kërkesën e marsit 2009, kërkuesve do ti akordohej shuma prej 450,000 euro si shpërblim për dëmin material dhe jomaterial.

GJYLI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 32907/07)***29 shtator 2009****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Gjyli, punonte si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional Durrës, pranë SHKP dhe në korrik 2005 u hoq nga puna. Në shtator 2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e deklaroi të pavlefshme heqjen e tij nga puna dhe urdhëroi kthimin e tij në vendin e punës. Gjykata e Apelit nuk pranoi të shqyrtonte apelimin e SHKP për shkak të kalimit të afatit, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nxorri një vendim për pagat e humbura, vendim i cili nuk ishte ekzekutuar. Kërkuesi pretendoi për shkelje të nenit 6 § 1 si dhe nenit 13 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të vitit 2006 të Gjykatës së Rrethit, Gjykata u shpreh se ky vendim ishte lënë pezull nga GJL dhe Gjykata nuk mund të shprehej për të.

Gjithashtu, Gjykata arsyetoi se autoritetet shqiptare nuk kishin bërë asnjë përpjekje për ti ofruar kërkuarit një zgjidhje alternative, duke vlerësuar kështu si të pajustificueshme periudhën e moszbatimit të vendimit. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 13, Gjykata u shpreh se kërkuari nuk e kishte dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, ajo arsyetoi se vendimet e GJK kishin karakter deklarativ dhe nuk i mundësonin kërkuarve zgjidhje ose dëmshpërblime efektive. Në këtë kuptim, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13. Bazuar në nenin 41, Gjykata i akordoi kërkuarit 2,100 euro për dëmin material dhe 2,500 euro për shpenzimet gjyqësore.

HAMZARAJ kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 45264/04)

3 shkurt 2009

I. Faktet kryesore

Në janar 1995 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë i njohu kërkuarës të drejtën e pronësisë të trashëguar për një sipërfaqe toke, pronë e cila i ishte konfiskuar babait të saj. Në mars 1996, KKKP Lushnjë i njohu të drejtën e pronësisë së kërkuarës dhe pesë trashëgimtarëve të tjerë dhe vendosi që ata të kompesoheshin në natyrë ose me bono shtetërore, meqenëse kthimi i pronës ishte i pamundur. Në 2004 kërkuarja iu drejtua autoriteteve për të zbatuar vendimin e Komisionit në favor të saj, por asnjë veprim nuk u ndërмор. Kërkuarja pretendoi për shkelje të nenit 6 § 1, nenit 1 të Protokollit nr.1, si dhe nenit 46 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata arsyetoi se, mosekzekutimi nga ana e autoriteteve i vendimit të Komisionit, cenonte të drejtën e saj për të pasur akses në drejtësi. Nga ana tjetër edhe kohëzgjatja e procedurave për mëse 12 vite, ishte e pajustificuar në kuptimin e një “afati të arsyeshëm”. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1, Gjykata u shpreh se mosekzekutimi i vendimit kishte cenuar të drejtën e kërkuarës për gëzimin e qetë të pronës së saj dhe në këtë kuptim, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të këtij neni. Sa i takon nenit 46 dhe 41, Gjykata konstatoi shkelje dhe i akordoi kërkuarës një dëmshpërblim prej 12,500 eurosh në lidhje me dëmin material, si dhe 5,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

MARINI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 3738/02)

07 korrik 2008

I. Faktet kryesore

Kërkuari, Vlash Marini, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1936 që jeton në Tiranë. Çështja konsiston në ankesën e kërkuarit lidhur me pesë seri procedimesh në gjykatat e brendshme për një konflikt me qeverinë shqiptare, mbi një kompani të përbashkët sipërmarrëse që kishte ngritur në 1991, e cila ishte e specializuar në prodhimin e materialeve plastike. Ndër të tjera, kërkuari u ankua për mungesën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese, e cila kishte hedhur poshtë ankesën e tij. Kërkuari pretendoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1, nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte pasur tre shkelje lidhur me nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) lidhur me të drejtën e kërkuarit për akses në gjykatë, moszbatimin e vendimit përfundimtar, si dhe kohëzgjatjen e tepërt të proceseve. Gjykata më tej konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për ankim efektiv) në lidhje kohëzgjatjen e procedurave të ankimit të kërkuarit dhe shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës). Së fundi, Gjykata konkludoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 lidhur me të drejtën e kërkuarit për akses në gjykatë në lidhje me një urdhër likuidimi dhe kohëzgjatjen e procedimit të tretë, të katërt dhe të pestë. Kërkuarit iu akorduan 330,000 euro për dëmet materiale dhe jomateriale dhe 5,700 euro për shpenzimet gjyqësore.

QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 54268/00)

18 nëntor 2004

I. Faktet kryesore

Kërkuari është një kompani shqiptare, e cila pas refuzimit nga Bashkia e Tiranës për dhënie e një leje ndërtimi në tokën të cilën kërkuari e kishte blerë nga Komuna dhe për të cilën kishte marrë leje ndërtimi, filloi proces në gjykatë duke kërkuar kompensim prej 60,000,000 lekësh. Kërkesa u hodh poshtë, por u apelua me sukses. Në një vendim të 23 shkurtit 1996, Gjykata e Apelit Tiranë i dha kërkuarit 60,000,000 lekët e pretenduara. Kërkuari ndërmori hapa të ndryshëm për të siguruar ekzekutimin e vendimit të gjykatës, duke e sjellë në fund

para Gjykatës Kushtetuese, e cila konstatoi se zbatimi i vendimeve gjyqësore ishte jashtë juridiksionit të saj. Kërkuesi pretendonte për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të dështimit të autoriteteve shqiptare për të përmbushur një vendim të formës së prerë.

II. Vendimi i Gjykatës

Lidhur me pretendimin e kërkuesit për nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt), Gjykata nënvizoi se ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhej të konsiderohej si pjesë përbërëse e “gjykimit” në kuptim të nenit 6. Gjykata hodhi poshtë arsyetimin e shtetit se mungesa e fondeve ishte bërë shkak për mospërmbushjen e borxhit gjyqësor. Pa dyshim, një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë e tillë që të dëmtojë thelbin e të drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 § 1. Kërkuesit iu atribua shuma prej 60,000,000 lekësh (e përcaktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë), 70,000 euro për dëmet materiale dhe jomateriale, si dhe 2,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

BESHIRI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 7352/03*)

22 gusht 2006

I. Faktet kryesore

Kërkuesit, Njazi Beshiri, Liri Kaba, Xhilda Koka dhe Sair Preza, janë shtetas shqiptarë. Ata ankoheshin për moszekzekutimin e një vendimi që u akordonte atyre kompensim në lidhje me dy sipërfaqe toke. Ata pretendojnë shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm), nenit 13 (e drejta për ankim efektiv), nenit 1 i Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejtë se vendimi në fjalë nuk u zbatua për më shumë se pesë vjet, një situatë për të cilën qeveria shqiptare nuk kishte dhënë ndonjë justifikim bindës. Mungesa e fondeve shtetërore, siç kishte paraqitur Qeveria, nuk e justifikonte situatën. Lidhur me këtë, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte kërkesën sipas nenit 14 dhe deklaroi pjesën e mbetur të kërkesës si të papranueshme. Kërkuesve iu akordua bashkërisht, 120,000 euro në lidhje me dëmin material dhe jomaterial dhe 6,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

GJONBOÇARI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 10508/02*)

23 tetor 2007

I. Faktet kryesore

Kërkuesit janë shtatë vëllezër dhe motra, shtetas shqiptarë që jetojnë në Tiranë dhe Vlorë. Rasti ka të bëjë me ankesat e tyre në lidhje me procedimet në të cilat ata pretendonin kthimin e tokës që u përkiste prindërve të tyre, por që ishte konfiskuar nga shteti pa shpërblim. Ata pretendojnë shkelje të nenit 6 § 1, neni 13 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me dështimin për të zbatuar për më shumë se katër vjet, vendimin përfundimtar në favor të ankuesve. Duke pasur parasysh këtë konstatim, gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej më vete ankesa sipas nenit 13. Gjykata më tej konsideroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të kohëzgjatjes të serisë së tretë të procedimeve. Lidhur me këtë ankesë, Gjykata arsyetoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1. Kjo ishte hera e parë që Gjykata ka konstatuar se sistemi juridik shqiptar nuk ka arritur të sigurojë një mjet efektiv juridik në respektimin e të drejtës për “dëgjimin brenda një kohe të arsyeshme”. Secilit kërkues iu akordua 7,000 euro për dëmin jomaterial. Pjesa tjetër e kërkesës u shpall e papranueshme.

RAMADHI dhe të tjerë kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 38222/02*)

13 nëntor 2007

I. Faktet kryesore

Kërkuesit janë gjashtë vëllezër dhe motra, shtetas shqiptarë që jetojnë në Kavajë dhe Durrës. Gjatë regjimit komunist, disa sipërfaqe toke dhe dy dyqane në pronësi të babait të tyre u konfiskuan nga autoritetet pa kompensim. Kërkuesit u ankuan për dështimin e autoriteteve për zbatimin e vendimeve në favor të tyre dhe tre prej tyre u ankuan se gjykatat vendase i kishin diskriminuar ata në bazë të vendbanimit të tyre. Ata pretendonin shkelje të nenit 6 § 1, nenit 13, nenit 1 të Protokollit nr. 1, nenit 14, si dhe nenit 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Lidhur me nenin 6 § 1 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata arsyetoi se vendimi i formës së prerë kishte ngelur i pazbatuar dhe autoritetet shtetërore kishin dështuar në zbatimin e vendimit duke ndërhyrë në të drejtën e tyre për të gëzuar pronën. Përsa i përket pretendimit për shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1, Gjykata argumentoi se, pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për ekzekutim kishte marrë formën e një vendimi gjyqësor ose të një autoriteti administrativ, ligji i brendshëm si dhe Konventa parashikonin zbatimin e tij. Megjithatë, nuk u ndërmor asnjë hap për të zbatuar vendimet në favor të kërkuësve, dhe për rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të këtij neni. Gjithashtu, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 46. Gjykata konkludoi se, tre ankuesit e fundit nuk e kishin ngritur çështjen e diskriminimit para gjykatave vendase dhe ankesa e tyre për shkelje të nenit 14 ishte e papranueshme.

DRIZA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 33771/02)

13 nëntor 2007

I. Faktet kryesore

Kërkuesi, Ramazan Driza, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1941 dhe jeton në Tiranë. Në Shqipërinë e paraluftës, babai i tij zotëronte një furrë buke në Tiranë dhe një sipërfaqe toke. Në vitin 1960 autoritetet shqiptare shkatërruan ndërtesën dhe e shpronësuan tokën. Z. Driza ankohej për padrejtësinë e procesit civil dhe mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë në favor të tij. Ai pretendonte shkelje të nenit 6 § 1, nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se, në dhënien e lejes për të shqyrtuar një vendim të formës së prerë dhe lejimin e kryerjes së proceseve paralele, Gjykata e Lartë kishte hedhur poshtë një proces të tërë gjyqësor, i cili kishte përfunduar me një vendim gjyqësor të plotfuqishëm dhe të zbatueshëm. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike, paanshmërisë së gjykatës dhe moszbatimin e vendimeve të formës së prerë. Gjykata vuri në dukje se dështimi i autoriteteve për të zbatuar vendimet në favor të kërkuësit, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pronës dhe vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata konstatoi se Qeveria kishte dështuar të vendoste një procedurë të përshtatshme në lidhje me kërkesat për kompensim. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 13 lidhur me ankesën sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1.

DAUTI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 19206/05)

3 shkurt 2009

I. Faktet kryesore

Kërkuesi, Ramiz Dauti, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1947 dhe jeton në Tiranë. Kërkuesi ishte shpallur i paaftë për punë me vendim të KMCAP. Vendimi u anulua më pas nga vetë ky komision dhe gjykatat vendase nuk morën në shqyrtim padinë e kërkuësit me argumentin se këto vendime janë të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit gjyqësor. Qëndrim të njëjtë mbajti dhe GJL dhe GJK. Ai pretendoi shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, me arsyetimin se nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë para gjykatave vendase vendimet e organeve administrative në lidhje me përfitimet e aftësisë së kufizuar.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë nuk përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe se vendimet e saj në atë kohë, nuk mund të kundërshtoheshin përpara një gjykate vendase. Gjykata vendosi në mënyrë unanime se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Ajo më tutje konstatoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa e kërkuësit sipas nenit 13 dhe i akordoi atij 6,000 euro për dëmin jomonetar.

NURI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 12306/04)

3 shkurt 2009

I. Faktet kryesore

Kërkuesja është shtetase shqiptare, të cilës i ishte njohur e drejta e pronësisë mbi dy vila, një truell me sipërfaqe 580 m² dhe bashkëpronësia mbi një vilë të tretë, prona të cila i ishin konfiskuar babait të saj në 1949. Sipërfaqja e truallit u vendos të kompesohej me bono shtetërore meqë ishte i zënë, por asnjë veprim konkret nuk u ndërmor për këtë kompesim. Kërkuesja pretendoi shkelje të nenit 6 § 1, nenit 1 i Protokollit nr. 1, si dhe të nenit 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata në shqyrtimin e kësaj çështje risolli argumentat e çështjes *Ramadhi k. Shqipërisë*. Lidhur me nenin 6 § 1 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata arsyetoi se autoritetet shtetërore kishin dështuar në zbatimin e vendimit të formës së prerë, duke ndërhyrë në të drejtën e kërkuarit për të gëzuar pronën. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 46. Në kuadër të shpërblimit të drejtë, Gjykata i akordoi kërkuarës një dëmshpërblim prej 71,500 eurosh në lidhje me dëmin material dhe 5,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial.

SHARXHI dhe TË TJERËT kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 10613/16)

11 janar 2018

I. Faktet kryesore

Kërkuarët janë 18 shtetas shqiptarë dhe një italian. Në gusht 2010 autoritetet lokale dhanë leje për të ndërtuar një rezidencë banimi në një sipërfaqe toke në Vlorë. Në 2013, INUK dhe policia rrethuan pallatin dhe nuk lejuan banorët të futeshin, me pretendimin se do të bëhej shqyrtimi i vlefshmërisë së lejes së ndërtimit. Gjykata Administrative, me kërkesë të bashkëpronarëve, urdhëroi INUK të ndalonte çdo lloj veprimtarie që cënonte të drejtën e tyre të pronës, por pavarësisht kësaj, ndërtesa u shkatërrua brenda dhjetorit 2013. Ndërkohë, Qeveria kishte miratuar një vendim për kompesimin monetar të bashkëpronarëve të pallatit, apelimi ndaj të cilit po mbahej pezull nga GJL, e cila në janar 2015 vendosi të mbajë vendimin e gjykatës më të ulët për shumën prej 11,639,800 euro kompesim. Kërkuarët bënë një sërë kërkesash bazuar në nenet: 6 § 1, 6 § 2, 8, neni 1 i Protokollit nr.1, 13 dhe 14 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 6 § 1, Gjykata arsyetoi se autoritetet e brendshme nuk e kishin marrë parasysh vendimin e Gjykatës së Rrethit për ndalimin e procedurave që mund të cenonin të drejtat e tyre pronësore, duke përbërë kështu shkelje. Sa i takon nenit 13, GJK mund të bënte vetëm një interpretim deklarativ të vendimit, por nuk mund t'i jepte një zgjidhje efektive kërkuarëve në lidhje me situatën. Duke arsyetuar kështu, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13. Më tej, Gjykata shqyrtoi pretendimin për nenin 8, duke arsyetuar se apartamentet e banimit përbënin “shtëpitë” e kërkuarëve, në termat e një banese familjare dhe të përhershme. Ndërhyrja e autoriteteve duke i ndaluar atyre aksesin në shtëpitë e tyre kishte cenuar kështu të drejtën për jetë familjare, që sigurohet nga neni 8 i Konventës. Në lidhje me të drejtën pronësore, Gjykata u shpreh se rrethimi dhe shkatërrimi i ndërtesës kishin qenë të paligjshme, duke shkelur qartazi të drejtën e kërkuarëve

për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e tyre, mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr.1. Sa i takon shpërblimit të drejtë, në bazë të nenit 41, Gjykata i akordoi kërkuarëve 13,098,600 euro në lidhje me dëmin material, nga 7,800 euro si shpërblim për dëmin jomaterial dy kërkuarëve të parë dhe nga 13,000 euro secilit prej kërkuarëve të mbetur, si dhe 112,100 euro në total për shpenzimet gjyqësore.

IZET HAXHIA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 29861/03)

5 nëntor 2013

I. Faktet kryesore

Kërkuarësi, z. Haxhia, ishte cilësuar nga prokuroria si i dyshuar për vrasjen e Azem Hajdarit, ish-deputet i Parlamentit të Shqipërisë dhe i një prej trupprojave të tij, si dhe për plagosjen e trupprojës tjetër. Z. Haxhia iu caktua një avokat dhe në mars 2000 ai u gjykua në mungesë. Në prill 2001 Gjykata e Tiranës dha vendimin kundër kërkuarësit në mungesë, me 25 vjet heqje lirie. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Kërkuarësi pretendoi për shkelje të nenit 6, në lidhje me zhvillimin e procedimeve penale të padrejta ndaj tij, si dhe dënimit në mungesë.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata konstatoi se kërkuarësi nuk kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të dalë në gjyq, po kjo e drejtë atij i ishte mohuar, duke mos i dhënë mundësinë e rishqyrtimit të çështjes së tij në themel, nga një gjykatë që do ta dëgjonte atë si palë aktive në procesin e zhvilluar kundër tij, çka do të ishte në përputhje me garancitë për një gjykim të drejtë sipas nenit 6. Si rrjedhojë, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt).

CANI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 11006/06)***6 mars 2012****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Besnik Cani, është një shtetas shqiptar i cili ka lindur në vitin 1969 dhe aktualisht po vuan dënimin me 25 vjet burg në Lushnje, për disa vepra penale, ndër të tjera edhe për vrasje. Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 dhe 6 § 3 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Z. Cani u ankua për parregullsinë e proceseve penale ndaj tij, në veçanti për shkak të faktit se atij nuk iu dha mundësia të mbronte veten personalisht në një seancë dëgjimore publike gjatë procesit në Gjykatën e Apelit.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se, ishte e një rëndësie themelore që i pandehuri të paraqitej në gjykimin e tij, si për shkak të së drejtës së tij për proces të rregullt, ashtu dhe për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e deklaratave të tij. Megjithatë prania e të pandehurit në Gjykatën e Apelit ka një rëndësi më të vogël se prania e tij në gjykimin e shkallës së parë, kur apeli bën një rivlerësim të fajësisë apo pafajësisë, nuk mund t'a përcaktojë pa një vlerësim të drejt-përdrejtë të provave të dhëna personalisht. Gjykata konstatoi se kërkuesi nuk pati mundësinë të argumentonte personalisht se ekzistonin faktorë lehtësues ndaj tij dhe nuk mundi të dëgjohej në seancë, në asnjë fazë të procedimeve në Apel. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 të Konventës.

SHKALLA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 26866/05)***10 maj 2011****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi Ardian Shkalla, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1978, i cili aktualisht po vuan dënimin me burgim të përjetshëm për vrasje. Ai u ankua se procedimet penale që çuan në dënimin e tij në janar të vitit 2003 ishin të padrejta për shkak se kërkuesi jetonte në Greqi në atë kohë dhe procedimet ishin mbajtur në mungesë të tij. Ai gjithashtu u ankua se, pasi u dorëzua në policinë shqiptare në qershor 2003, gjykatat e kishin refuzuar ankesën e tij kushtetuese si të parashtruar jashtë afatit. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute, por i nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi. Megjithatë, kufizimet nuk duhet të pakësojnë aksesin e një personi në një mënyrë apo shtrirje të tillë që dëmton vetë thelbin e së drejtës, pra kufizimet duhet të jenë në përputhje me nenin 6 § 1 dhe të ndjekin një qëllim legjitim. Gjykata çmoi se, autoritetet shqiptare nuk kishin mundur të tregonin nëse kërkuesi kishte dijeni të mjaftueshme për proceset gjyqësore që po zhvilloheshin ndaj tij, si rrjedhojë ajo u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Gjykata i akordoi kërkuesit një dëmshpërblim prej 4 000 eurosh për shpenzimet gjyqësore.

BERHANI kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 847/05)***27 maj 2010****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Berhani, është një shtetas shqiptar i dënuar me 18 vite burgim për vrasje me paramendim të kryer në vitin 1996. Në janar të vitit 2000, kërkuesi u dënua nga Gjykata e Rrethit Berat me 18 vite burg, në një seancë gjyqësore në të cilën kërkuesi ishte në mungesë pasi ishte shpallur i arratisur, por përfaqësohej nga një avokat i caktuar kryesisht. Pas ekstradimit të tij nga Italia, kërkuesit iu dha mundësia të përfaqësohej në Apel, megjithatë Gjykata e Apelit, ashtu sikurse Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese, lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Berat për dënimin e kërkuesit me 18 vite burgim. Kërkuesi pretendon se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës, në lidhje me tejzgjatjen e procedurave si dhe gjykimin e papazuar në fakte që ishte bërë ndaj tij.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata arsyetoi se gjykatat e brendshme nuk i ishin përgjigjur pretendimit të kërkuesit për pamundësinë e identifikimit të tij, duke qenë se vrasësi kishte qenë i pajisur me kasketë motoçikete dhe nga ana tjetër, procesverbalet e paraqitura në proces nuk tregonin se ishin gjetur shenja të gishtërinjve të kërkuesit në ndonjë nga provat e marra nga vendi i krimit. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se proceset e gjykatave vendase ishin kryer në shkelje të nenit 6. Në lidhje me pretendimin për tejzgjatje të proceseve, Gjykata u shpreh se koha e procedimeve në gjykatat vendase nuk kishte kaluar 'afatin e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme'. Sa i takon zbatimit të nenit 41 të Konventës, Gjykata i akordoi kërkuesit një shpërblim prej 4,800 eurosh për dëmin jomaterial.

LASKA dhe LIKA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 12315/05 dhe 17605/04)***20 prill 2010****I. Faktet kryesore**

Kërkuesit, z. Laska dhe z. Lika janë dy shtetas shqiptarë që aktualisht vuajnë dënimin në burgun e Burrelit. Në 31 mars 2001, në një autobus të linjës Tiranë-Kukës ndodhi një grabitje me armë dhe dëshmitarët identifikuan viktimat si të veshur me bluza të bardha dhe kapuçat blu. Policia kërkoi në shtëpitë përreth vendit të ngjarjes dhe hyri pa autorizim në shtëpinë e z. Laska, ku ndodhej gjithashtu edhe z. Lika. Policia i gjeti kërkuesve rrobat që kishin përshkruar viktimat si dhe granata. Në një proces identifikimi që u mbajt në polici, viktimat vazhdimisht identifikonin Likën dhe Laskën si agresorët e tyre. Në prill 2001 kërkuesit u akuzuan për grabitje me armë dhe armëmbajtje pa leje dhe u dënuan me 30 vite burgim. Kërkuesit ishin ankuar për keqtrajtim në burg dhe për faktin se policët i presiononin të tregonin vendin ku kishin fshehur sendet e vjedhura dhe armët e përdorura. Ata pretenduan për shkelje të nenit 3, 6 § 1 dhe 46 të Konventës.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se kërkuesit nuk kishin shteruar mjetet e brendshme të ankimit ndaj keqtrajtimit të pretenduar në paraburgim, rrjedhimisht ajo nuk mund të shqyrtonte kërkesën për shkelje të nenit 3. Sa i takon nenit 6 § 1, Gjykata u shpreh se policia i kishte marrë provat në shkelje të ligjit, pa pasur autorizimin për të kontrolluar shtëpinë e kërkuesit, kishte kryer procedurat e hetimit penal pa praninë e avokatit të kërkuesve, si dhe në procesin e identifikimit, kishte detyruar kërkuesit të vishnin kapuçat blu ndërsa personat e tjerë ishin veshur me kapuçat të zinj, çka e bënte shumë të thjeshtë identifikimin e kërkuesve si agresorët e mundshëm. Për sa më sipër, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Në lidhje me nenin 46, Gjykata i akordoi secilit prej kërkuesve një shumë prej 4,800 eurosh si dëm jomaterial, ndërkohë që u shpreh se për të pasur një dëm material duhet të kishte një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore midis moszbatimit të Konventës dhe dëmit material të pësuar prej këtij fakti.

CAKA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 44023/02)***8 dhjetor 2009****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Caka është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1970. Kërkuesi u akuzua në 2 raste të ndryshme për vrasje me paramendim dhe vrasje të mbetur në tentativë, si dhe për armëmbajtje pa leje. Gjatë proceseve gjyqësore kundër tij, kërkuesi u përfaqësua disa herë nga avokatë dhe disa herë u vetëpërfaqësua. Në tetor 2000 Gjykata e Apelit rrëzoi pretendimin e kërkuesit për shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt dhe të njëjtin qëndrim mbajtën dhe Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese. Kërkuesi pretendoi në GJEDNJ për shkelje të nenit 6 si dhe kërkoi zbatimin e nenit 41 të KEDNJ.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata arsyetoi se, kërkuesi nuk kishte shfaqur pamundësi për të pasur një avokat, duke qenë se ai kishte ndërruar pesë të tillë dhe nga ana tjetër, në seancat ku ai nuk përfaqësohej nga një avokat, nuk ishte administruar asnjë provë e re që ndikonte në dënimin e z. Caka. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me nenin 6 §1 të Konventës. Nga ana tjetër, Gjykata çmoi se pamundësia e shtetit për të siguruar pjesëmarrjen e dëshmitarëve në seancë dhe zbatimin e fletëthirrjes së saj, nuk siguronte zbatimin e të drejtave të garantuara nga neni 6. Si rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës. Sa i takon akuzës për vrasjen e P., Gjykata vërejtë se gjykatat vendase nuk kishin siguruar si dëshmitarë në sallë personat që kishin dhënë përshkrimin për z. Caka, duke i çenuar atij të drejtën për ti pyetur ata. Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 3 (d) të Konventës. Sa i takon nenit 41, Gjykata i akordoi 3,000 euro në kuadër të dëmit jomaterial.

HAXHIA kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 29861/03)***dhe****MULOSMANI kundër SHQIPËRISË***(kërkesa nr. 29861/03)***8 tetor 2013****I. Faktet kryesore**

Çështjet kanë të bëjnë me dy policë të kategorisë të lartë të akuzuar dhe dënuar për vrasjen e Azem Hajdarit në vitin 1998, deputet i PD, si dhe trupprojës së tij. Haxhia ishte ish-drejtuesi i policisë rrugore dhe z. Mulosmani, kreu i rendit publik në Bajram Curri. Të dy u dënuan në prill të vitit 2002: z. Mulosmani për vrasjen e deputetit dhe z. Haxhia për ndihmën dhe inkurajimin e vrasjes, dënime që u mbështetën nga GJL dhe GJK. Ata të dy bënë një sërë ankimesh sipas nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 të Konventës. Veçanërisht, ata pretenduan se gjykatat kombëtare pranuan prova të cilat ishin kontradiktore dhe nuk ishin të besueshme, dhe se vendimet e tyre nuk ishin të arsyetuara mirë. Ata gjithashtu pretendonin se avokatëve të tyre nuk u ishte dhënë kohë e mjaftueshme për të studiuar dosjen e hetimit dhe mundësia për të marrë të gjitha dokumentet në dosje. Ata më tej pretenduan se akuzat kundër tyre janë riklasifikuar gjatë procesit të apelimit, nga vrasja me paramendim mbi baza politike, në vrasje për hakmarrje, pa u dhënë atyre kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur. Gjithashtu, të dy kërkuesit pretenduan për shkelje sipas nenit 6 § 2 në lidhje me deklaratat e bëra në publik për fajësinë e tyre, nga figura politike.

II. Vendimi i Gjykatës

Lidhur me pretendimin e kërkuesve për shkelje të nenit 6 § 1 dhe 6 § 3, Gjykata vërejti se pas marrjes dijeni se dosja ishte tepër voluminoze, avokati i z. Haxhia në seancën e parë gjyqësore kishte kërkuar shtyrje duke qenë se i nevojitej më tepër kohë për të shqyrtuar dosjen. Gjithashtu, z. Mulosmani fillimisht kishte kërkuar të vetëpërfaqësohej dhe më pas kishte kërkuar të përfaqësohej me avokat, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata. Lidhur me provat, Gjykata u shpreh se dëshmia e z. Berisha, i cili nuk kishte qenë dëshmitar okular, nuk ishte pranuar si provë nga gjykatat vendase. Për sa më sipër, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 të Konventës. Lidhur me pretendimin e z. Mulosmani se deklarata e z. Berisha kishte cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, Gjykata u shpreh se deklarata nuk ishte bërë nga një funksionar publik, pasi në atë kohë z. Berisha mbante postin e kryetarit të partisë opozitare, e cila ishte juridikisht dhe financiarisht e pavarur nga shteti. Ndërsa për z. Haxhia ky pretendim nuk u mor në konsideratë duke qenë se nuk ishte ngritur si pretendim para gjykatave vendase.

BALLIU kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 74727/01)***16 qershor 2005****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Taulant Balliu, është shtetas shqiptar që aktualisht vuan dënimin me burgim të përjetshëm në burgun e Peqinit. Në vitin 1999 ai u akuzua për pesë akuza për vrasje, dy akuza për vrasje të mbetur në tentativë, një akuzë për posedim të armëve ushtarake dhe një akuzë për krijimin dhe pjesëmarrjen në një bandë të armatosur të njohur si “Kateshi Gang”. Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 6 § 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut me arsyetimin se i ishte mohuar procesi i rregullt ligjor, pasi nuk ishte mbrojtur siç duhet përmes ndihmës juridike dhe se nuk kishte qenë në gjendje të merrte në pyetje dëshmitarët e caktuar ose të merrte dëshmitarë në emër të tij.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se autoritetet kishin përmbushur detyrimin e tyre për të ofruar ndihmë juridike, duke i shtyrë seancat për t'i dhënë këshilluesit të kërkuesit mundësinë për të përmbushur detyrën e tij dhe duke emëruar një avokat të skemës së ndihmës ligjore. Duke pasur parasysh edhe detyrimin e autoriteteve sipas nenit 6 § 1 të Konventës për të zhvilluar procedurat “brenda një afati të arsyeshëm”, rrethanat e mungesës së përfaqesit gjatë gjykimit nuk tregojnë dështim për të ofruar ndihmë juridike sipas nenit 6 § 3 (c) ose mohim të një procesi të rregullt sipas paragrafit 1 të kësaj dispozite. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c). Për më tepër, gjatë seancave dëgjimore, si kërkuesi ashtu dhe avokati i tij, kishin pasur mundësi t'i parashtronin pyetje dëshmitarëve të prokurorisë, megjithëse kishin zgjedhur të mos e bënin këtë. Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se autoritetet kishin dështuar në përmbushjen e detyrës së tyre sipas nenit 6 § 1 dhe 3 (d). Pra nuk ka pasur shkelje të këtij neni.

XHERAJ kundër SHQIPËRISË*(kërkesa nr. 37959/02)***29 korrik 2008****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Arben Xheraj, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1970 që aktualisht vuan dënimin 16 vjeçar në burgun e Vicenzës për trafikim droge. I liruar nga burgun në Shqipëri në dhjetor të vitit 1998, z. Xheraj ankohet për padrejtësinë e procedimeve për të rishqyrtuar vendimin e gjykatës që e la atë të lirë, dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë për revokimin e shfajësimit të tij përfaqëson një sanksion penal të dytë për të njëjtën vepër penale. Ai pretendoi shkelje të nenit 6 § 1 dhe 3 (c) dhe nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se, edhe pse neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës ndalonte një ndjekje ose gjykim të dytë, ai lejonte rihapjen e një gjykimi në rrethana të jashtëzakonshme. Gjykata konkludoi se për qëllime të parimit *ne bis in idem*, kërkesa për rivendosi në afat nuk përmbente një gjykim të dytë. Për rrjedhojë, nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7. Sa i takon rivendosi në afat të apelit të çështjes, Gjykata u shpreh se, miratimi i kërkesës së prokurorit nuk vendoste baraspeshë mes interesit të kërkuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e drejtësisë penale, duke shkelur parimin e sigurisë juridike garantuar nga neni 6 § 1. Në lidhje me nenin 41, Gjykata u shpreh se nuk kishte evidentuar ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljeve të kryera dhe dëmit material të pretenduar, kështu që vendosi se kërkuesit do ti akordohej vetëm shuma prej 2,000 euro për dëmin jomaterial.

NENI 7 NUK KA DËNIM PA LIGJ**ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË***(kërkesa nr. 20134/05)***2 qershor 2005****I. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Vehbi Alimuçaj, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1949 në Vlorë. Ai është ish-pronar i një kompanie tregtare, Vefa Holding sh.pk. Në prill 1998, z. Alimuçaj u arrestua me akuza për mashtrime të përsëritura dhe skema mashtruese të huamarrjes. Në nëntor të vitit 2002, Gjykata e Lartë e shpalli atë fajtor për 57,923 akuza mashtrimi dhe e dënoi me 20 vite burg. Ai u lirua në maj 2010, pasi kishte shërbyer pjesën e mbetur të dënimit të tij, e cila u reduktua nga një akt amnistie nga puna në burg dhe nga falja presidenciale. Kërkuesi pretendonte se vuante nga probleme serioze kardiake dhe ankohej për kujdesin e pamjaftueshëm mjekësor gjatë vuajtjes së dënimit në burg. Ai pretendonte shkelje të neneve 2, 3, 5, 6 si dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se kërkuesi ishte ndjekur penalisht dhe ishte dënuar sipas nenit 143 të Kodit Penal, i cili parashikon dënim për veprën penale të mashtrimit. Baza ligjore për ndjekjen penale të kërkuesit ishte ligji penal i zbatueshëm në kohën kur po zhvillohej gjyqi. Gjykatat vendase cilësuan se kërkuesi në mënyrë të qëllimshme kishte konsumuar veprën penale të mashtrimit dhe Gjykata konstatoi se ky cilësim nuk ishte arbitrar dhe i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata nuk vërejti shkelje të nenit 7 të Konventës në këtë aspekt. Sa i takon mënyrës së llogaritjes së dënimit, Gjykata konstatoi se dënimi i kërkuesit ishte llogaritur në bazë të një dispozite, e cila ishte miratuar pasi vepra penale ishte kryer dhe rëndonte pozitën e kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata e cilësoi këtë vendim të gjykatave shqiptare si të paligjshëm dhe çmoi se kishte pasur shkelje të të drejtave të parashikuara nga neni 7 i Konventës (nuk ka dënim pa ligj).

NENI 8 E DREJTA PËR RESPEKTIMIN E JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE

BAJRAMI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 35853/04)

12 dhjetor 2006

I. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Bajrami, në vitin 1998 u nda nga gruaja e tij, e cila më pas u zhvendos së bashku me vajzën për të jetuar me prindërit e saj. Kërkuesi e pa vetëm dy herë vajzën e tij pas ndarjes, pasi ish-bashkëshortja dhe prindërit e saj refuzuan t'i jepnin atij akses. Në vitin 2003 ai paraqiti procedurat e divorcit, duke i kërkuar në të njëjtën kohë policisë të anulonte pasaportën e vajzës së tij, duke pasur parasysh faktin se gruaja e tij po planifikonte ta çonte atë në Greqi pa pëlqimin e tij. Kundrejt kësaj kërkesë, gruaja e kërkuesit arriti të marrë vajzën e saj në Greqi. Kërkuesit iu dha më vonë kujdestaria e fëmijës, por vendimi nuk u zbatua. Z. Bajrami pretendonte shkelje të nenit 8 § 1 të Konventës pasi nuk kishte asnjë mjet të veçantë për parandalimin ose ndëshkimin e rrëmbimit të fëmijëve nga territori i shtetit, duke rezultuar kështu në mosekzekutimin e dhënies së kujdestarisë.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se vendimi kujdestarisë nuk ishte ekzekutuar për rreth dy vjet, për të cilat nuk mund t'i atribuohet asnjë faj kërkuesit, i cili rregullisht kishte ndërmarrë hapa për të siguruar kthimin e vajzës së tij. Sipas ligjit shqiptar nuk kishte ndonjë mjet të posaçëm për të parandaluar apo ndëshkuar rastet e rrëmbimit të fëmijëve nga territori i vendit. Në veçanti, Shqipëria nuk është shtet palë në Konventën e Hagës dhe ende nuk ka zbatuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa KEDNJ kërkon nga shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar bashkimin e prindërve me fëmijët, në përputhje me një vendim përfundimtar të një gjykate vendase. Sistemi ligjor shqiptar nuk ofronte ndonjë rregullim alternativ që i jepte kërkuesit mbrojtjen praktike dhe efektive, që kërkohej nga detyrimi pozitiv i shtetit, i parashikuar në nenin 8. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.

QAMA kundër SHQIPËRISË dhe ITALISË

(kërkesa nr. 4604/09)

8 janar 2013

I. Faktet kryesore

Kërkuesi, Flamur Qama, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1960 dhe jeton në Durrës. Gruaja e tij e ndjerë u zhvendos në Itali në vitin 1999 me djalin e tyre, i lindur në vitin 1994. Z. Qama u bashkua me ta në një moment të dytë. Pas vdekjes së gruas së tij, një gjykatë italiane në vitin 2003 i dha kumatës së z. Qama kujdestarinë e fëmijës. Z. Qama u dëbua nga Italia në vitin 2002 për shkak të mungesës së lejes së qëndrimit. Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 8 të Konventës, ai u ankua se autoritetet shqiptare dhe italiane nuk i kishin siguruar të drejtën e kontaktit me djalin e tij, e drejtë kjo e dhënë nga gjykatat shqiptare në dy vendime, në 2006 dhe 2009.

II. Vendimi i Gjykatës

Gjykata deklaroi se çështja që duhej të merrej në shqyrtim ishte “shtrirja e detyrimeve pozitive të autoriteteve shqiptare, nëse kishte, për të zbatuar të drejtën e kontaktit të kërkuesit me fëmijën e tij”. Gjykata vuri në dukje se kujdestaria e fëmijës i ishte dhënë tezes së fëmijës, në bazë të një vendimi të gjykatës italiane në vitin 2003 dhe në asnjë fazë babai nuk i kërkoi gjykatave italiane ta ndryshonin vendimin e fundit, ose t'i jepnin atij të drejta aksesit. Për më tepër, babai nuk kishte pretenduar se fëmija ishte mbajtur gabimisht në Itali. I lexuar në dritën e Konventës së Hagës së vitit 1980 për rrëmbimin e fëmijëve, neni 8 i KEDNJ-së “nuk u atribuon autoriteteve kombëtare detyrime pozitive për të siguruar kthimin e fëmijës, nëse kërkuesi ka vetëm të drejta aksesit. Gjykata arriti në përfundimin se babai duhet të kishte paraqitur një padi në gjykatat italiane për të fituar të drejtën e aksesit në lidhje me fëmijën. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut kundër Shqipërisë", zbatuar nga Qendra Europiane dhe mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer, Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Jug-Lindore.

Përgatitën botimin:
MSc. Ina Xhepa

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk shprehin qendrim zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer. Ato janë të gjitha nën përgjegjësinë juridike dhe profesionale të autorëve.

© **Qendra Europiane dhe Konrad-Adenauer-Stiftung**

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, etj., pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Qendra Europiane
Rr. "Vaso Pasha"
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri
www.euro-centre.eu

Konrad-Adenauer-Stiftung
Programi i Shtetit të së Drejtës
për Evropën Jug-Lindore
Rr. Franzelari nr. 5
Sektor 2
RO-020785 Bukuresht, Rumani





Qendra Europiane

Rr. "Vaso Pasha"
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri
www.euro-centre.eu

Konrad-Adenauer-Stiftung

Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Jug-Lindore
Rr. Franzelari nr. 5
Sektor 2
RO-020785 Bukuresht, Rumani